

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31681410-0 Materiale elektrike;

44115200-1 Materiale hidraulike dhe ngrohje

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,666,545 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesqind e dyzet e pesë) lekë pa Tvsh

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2 dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht në vlerën: 33,330,9 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë pikë nëntë) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer ne numrin e llogarise se Autoritetit Kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e

mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqenëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2023,2024,2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet

tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara ndaj shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a. (UKT).

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të

Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së dhe nenin 12 pika 8 gërma g të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se materialet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe sipas sasisë dhe specifikave teknike të përshkruara nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin materiale të reja konform specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

2.3.3 Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 333 309 (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e nëntë) lekë pa TVSH

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i se njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të përgatitura nga specialistë të fushës si më poshtë:

- 1 Akse Mishelatori (Këtuç)
- 2 Bashkues Ø 25
- 3 Bashkues Ø 32
- 4 Bashkues Ø 50

- 5 Bashkues Ø 63
- 6 Beck me rreze 10m
- 7 Beck me rreze 15m
- 8 Brryl ½ Bronx
- 9 Brryl ¾ Bronx
- 10 Brryl 1" Bronx
- 11 Brryl Ø 50
- 12 Brryl Ø 63
- 13 Brryl plastik Ø 20
- 14 Brryl plastik Ø 25
- 15 Brryl Ø 32
- 16 Brryla 2" xigota
- 17 Butona Kasetash për Mekanizmat
- 18 Filtër mishelatori
- 19 Galixhan Kasetash WC
- 20 Galixhant për depozitë 1"
- 21 Galixhant për depozitë 1/2
- 22 Galixhant për depozitë 2"
- 23 Galixhant për kasetë WC me furnizim nga poshtë
- 24 Gomina eksentrike për WC
- 25 Gomina për WC
- 26 Izolant
- 27 Izolant kundër ujit
- 28 Kabull 3x1.5
- 29 Kabull 3x2.5
- 30 Kabull 5x4
- 31 Kaseta WC plastike (universal)
- 32 Kite për ujë 24L
- 33 Kundravalvul Bronx 1" për thithje + sitën
- 34 Kundravalvul Bronx 2 - ½ për thithje + sitën
- 35 Kundravalvul Bronx 2" për thithje + sitën
- 36 Llampë metal halide me dy dalje, fuqi 70 W, bazë RX7s bi-pin, temperatura e ngjyrës 4200K (ose ekuivalente)
- 37 Llamba Led të thjeshta zyre
- 38 Manikot ½ Bronx
- 39 Manikot ¾ Bronx
- 40 Manikot 2" xigota
- 41 Manikot 3" Xigota
- 42 Manikot Ø 25
- 43 Manikot Ø 32
- 44 Manikot Ø 50
- 45 Manikot Ø 63
- 46 Mekanizëm pishuar
- 47 Mekanizëm shkarkimi për kaseta WC
- 48 Mishelator dushi
- 49 Mishelator Lavamani
- 50 Mufte ¾ - ½
- 51 Mufte 1 - ¼ Bronx
- 52 Mufte 1 - ½ Bronx
- 53 Mufte 1 - ¾ Bronx
- 54 Mufte 2 - 1 ½
- 55 Mufte 2 - 1/2

- 56 Niples ½ Bronx
- 57 Niples ¾ Bronx
- 58 Niples 1" bronx
- 59 Pilet lavamani
- 60 Priza + celsa elektrike
- 61 "Prozhektor Metal Halide që përfshin llambën Philips MASTER HPI-T Plus 400W/645 E40 ose ekuivalente (Karakteristikat kryesore:
 - Llambë 400W, T46, xhami transparent, soket E40
 - Fluks ndriçues ~30,000–32,000 lumen, 4500K (Cool White), CRI ~65
 - Kërkon ballast dhe ignitor për HPI-T 400W
 - Jetëgjatësi deri 20,000 orë)"
- 62 Reduksion 1 - ¼ Bronx
- 63 Reduksion 1 - ½ Bronx
- 64 Reduksion 2 - 1 ½
- 65 Reduksion 3 - 2 ½ xigota
- 66 Reduksion Ø 25/63 plastike
- 67 Reduksion Ø 50; Ø 32
- 68 Reduksion Ø 63; Ø 50
- 69 Reduksion plastik Ø 25-20
- 70 Reduksion plastik Ø32-25
- 71 Reduksion tap 1" x 3/4
- 72 Reduksion tap 3/4 x 1/2
- 73 Rubineta dekorative
- 74 Rubineta për çizmat 1/2
- 75 Rubineta uji
- 76 Saraçineska 2"
- 77 Saraçineska 3/4
- 78 Saraçineskë ½ Bronx
- 79 Saraçineskë 1 - ½ Bronx
- 80 Saraçineskë 1" Bronx
- 81 Saraçineskë 10 At plastike
- 82 Saraçineskë 2 - ½ Bronx
- 83 Saraçineskë 3/4 xingato 30 At
- 84 Saraçineskë 3" Bronx
- 85 Saraçineskë Ø 25 plastike
- 86 Saraçineskë Ø 32 plastike
- 87 Saraçineskë Ø 50 plastike
- 88 Saraçineskë Ø 63 plastike
- 89 Set me 2x llamba PL-T 26 W + downlight OMS u211 BSC DWN PRE FSQ 226 + balast elektronik Philips HF-S 226 PL-T/C II SR, për instalim 220–240 V (ekuivalente)
- 90 Sifon Firzamonik për Lavamanët
- 91 Silikon anti myk
- 92 Silikon sallam + pompë
- 93 Sprucator vadije
- 94 Stafa Ø 32
- 95 Stafa Ø 50
- 96 Stafa Ø 63
- 97 Tapa ½ Bronx
- 98 Tapa ¾ Bronx
- 99 Tapa 1" Bronx
- 100 Tapa plastike Ø63
- 101 Tapa të ndryshme (3/4 x 1")

- 102 Teflon i madh
- 103 Telefon dushi
- 104 Ti Ø 25
- 105 Ti Ø 32
- 106 Ti Ø 50
- 107 Ti Ø 63
- 108 Ti Ø25 plastike 1/2
- 109 Tub fleksibël ½ - 3/8
- 110 Tub fleksibël 1/2
- 111 Tub fleksibël 1/2 inox
- 112 Tub Fresibel 40 cm për mishelator lavamani + bide
- 113 Tub Fresibel Femër-Femër 50 cm
- 114 Tub Fresibel mashkull-femer 60 cm
- 115 Tub Fresibel mashkull-femer 40 cm
- 116 Tub shkarkimi lavamani
- 117 Tub Ø 25
- 118 Tub Ø 32
- 119 Tub Ø 50
- 120 Tub Ø 63
- 121 Tuba fleksibël femër + femër (1/2, 40 cm)
- 122 Tuba fleksibël femër + femër (1/2, 60 cm)
- 123 Tuba fleksibël për mishelatorë (40 cm)
- 124 Xhunto Ø 25
- 125 Xhunto Ø 32
- 126 Xhunto Ø 50
- 127 Xhunto Ø 63
- 128 Zorrë Vadtje

Artikujt me Nr Rendor 117, 118, 119, 120 duhet të jenë tuba plastik 10 At.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

Vendi i lëvrimit të mallit: Materialet do të lëvrohen pranë magazinës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Kashar, Tiranë.

Afati i lëvrimit: Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës.